



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit / Departament Prostornog Planiranja, Gradnje i Stanovanje / Department of Spatial Planing, Construction and Housing

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jedinica Org.Unit	<i>DPK/2023</i>
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot.No	<i>4146/22</i>
Nr. i Faqeve Br. Stranica No Pages	<i>- 09 -</i>
Data: Datum: Date:	<i>21.07.22</i>
PRISHTINË / A	
No. 1	

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:				
PËR/ZA/TO:	Servet Spahiu, zv. Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-se			
CC:	Rineta Jashari, shefe e Kabinetit të Ministrit Driton Tafallari, këshilltar i Ministrit të MMPHI-se Ndriçim Mustafa, Departamenti i Prokurimit të MMPHI-se Avdullah Berisha, Divizioni i Financave në MMPHI			
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Xhemail Metolli, zv. Udhëheqës i Departamentit për Planifikim Hapësinorë, Ndërtim dhe Banim / DPHNB			
NGA/OD/FROM:	Ramë Hamzaj, Udhëheqës i Divizionit të Banimit/DPHNB			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për rishqyrtimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit me Nr. Protokollit 6003/20 date 28.12.2020			
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	1417/a	Lokacioni: Kucni: Extension:	Prishtinë	21.07.2022
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION				<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL				<input checked="" type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE				<input type="checkbox"/>

I nderuari z. Spahiu,

Duke ju dëshiruar shëndet të mirë dhe punë të mbare, përmes kësaj shkrese, po kërkojmë nga ju, që mundësisht të filloni iniciativën e bashkëbisedimit me Ministrin dhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme për të rishqyrtuar Marrëveshjen e Bashkëpunimit për realizimin e "Skemës së akomodimit me qira për personat e riadhesuar si mase emergjente të personave të riadhesuar si dhe përcaktimi i obligimeve të ndërsjella institucionale.

Përshkrim i gjendjes :

Ju njoftoj se pas nënshkrimit të këtij Memorandumi me Nr. Protokolli 6003/20 date 28.12.2020, buxheti vjetor për realizimin e këtij aktiviteti në vlerë prej 200,000.00 € (dyqind mijë euro e zero cent), fillimisht është transferuar nga kategoria “ Mallra dhe Shërbime” nga kodi i organizatës “ 214- Ministria e Punëve të Brendshme”, me kod të programit “20900 Ri integrimi i Personave të riatdhesuar” në kodin e organizatës “213 - Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit” tani Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me kod të programit “50400 Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit”. Kjo lëvizje/transferim i buxhetit është paraqitur edhe në Ligjin mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021. Po ashtu në këtë vit buxhetor 2022, ky projekt është i ndarë në Subvencione, por që pagesa është duke u realizuar nga Mallra dhe shërbime.

Bazuar në këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit Nr. Protokolli 6003/20 date 28.12.2020, Divizioni i Banimit së bashku me Financat e Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, jemi duke realizuar përgatitjen e procedurave për financimin e skemës së akomodimit me qira për personat e riatdhesuar, sipas Listave dhe shënimeve që i sjelle Departamenti për Ri integrimin e Personave të riatdhesuar (DRPR)-MPB.

Pagesat e realizuara që nga muaji Janar – dhjetor 2021 në vlerë prej 196,547.21 €, ndërsa për, ashtu siç janë paraqitur në tabelë nga Financat e MMPHI-se.

Tabela për realizimin e pagesave në skemën e akomodimit me qira për personat e riatdhesuar			
Muaj	Nr. familjeve	Nr. familjeve të paguara	vlera (€)
Janar	62	62	12,180.98
Shkurt	69	69	13,540.62
Mars	68	68	14,239.98
Prill	75	75	14,706.09
Maj	86	86	19,965.95
Qershor	87	87	18,167.11
Korrik	83	83	16,460.48
Gusht	87	87	18,019.09
Shtator	91	91	17,434.62
Tetor	89	88	18,047.12
Nentor	91	90	18,007.97
Dhjetor	83	80	15,777.20
Totali nga 200,000.00 €			196,547.21

Ndërsa ne Vitin buxhetor 2022 deri me tani kemi realizuar:

Muaj	nr I familejeve	nr.i familjeve te paguara	vlera
janar	84	84	16,610.57
shkurt	86	86	16,566.53
mars	90	90	19,191.99
prill	91	91	20,447.25
maj	93	93	19,438.88
totali			92,255.22

Kërkesë për anulim te Marrëveshjes se Bashkëpunimit Nr. Protokolli 6003/20 date 28.12.2020

Gjate procesit te realizimit te kësaj Marrëveshje, kemi hasur ne shume probleme siç janë:

- Shumëfishim i punëve administrative, qe nga pranimi i lendeve nga Departamenti për Ri integrimin e Personave te Riatdhesuar DRPR – Ministria e Punëve te Brendshme e deri te Financat e Ministrisë se Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, sepse te gjitha lendet fillimisht përgatitet nga DRPR ne bashkëpunim me Zyrtaret Regional dhe Zyrtaret Komunal qe MPB i kane ne teren.
- Procesi i gjate për kontrollimin e lendeve veç e veç për secilën lende pas pranimit te lendeve ne forme fizike nga DRPR /MPB, për shkak te ndjeshmërisë financiare dhe përgatitja e tyre nga Divizioni i Banimit për aprovim dhe dërgim ne Financat e Ministrisë për realizim te pagesave.
- Zyrtaret e Financave te Ministrisë, rregullisht kane ankesa për shkak te kapaciteteve te limituara njerëzore dhe afateve kohore për ekzekutimin e këtyre pagesave.

Andaj bazuar ne këtë gjendje faktike dhe duke u bazuar ne Nenin 5 te Marrëveshjes, kërkojmë nga ju qe te filloni procesin e bisedimeve me përfaqësuesit e MPB-se, per shfuqizimin e kësaj Marrëveshje dhe të rikthehet ky proces atje ku ka qene edhe viteve tjera paraprake për realizim sepse edhe ashtu i kane kapacitet njerëzore te trajnuara dhe te përgatitura për te realizua këtë aktivitet .

Bazuar ne këtë marrëveshje, gjate takimeve te rregullta qe kemi zhvilluar me përfaqësuesit e DRPR, te njëjtit janë deklaruar se shume me mire e kane realizuar këtë aktivitet kur këto lende janë përgatitur nga DRPR ne bashkëpunim me Financat e MPB-se dhe Zyrat Regjionale për Ri integrim qe i kane ne teren.

Te ri- alokohet buxheti nga kategoria “ Mallra dhe Shërbime” i kodit te programit “50400 Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit”, ne kod te programit “20900 Ri integrimi i Personave te riatdhesuar” ne kodin e organizatës “ 214- Ministria e Punëve te Brendshme”. Te ri-alokohet buxheti ne MPB

Bashkëngjitur me këtë shkrese do te keni Marrëveshjes se Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë se Punëve te Brendshme dhe Ministrisë se Ekonomisë dhe Ambientit me Nr. Protokolli 6003/20 date 28.12.2020.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVË / VLADA KOSOVO / GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME / MINISTARSTVO UNUTRAŠNJI POSLOVA MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS Kabineti / Kabineti / Cabinet of the Minister		
Krij./No.	1055	14. Krij./No. Str. / 1
Data/Datum/Dato	28.12.2020	
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA		



REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT		
Njësi Org. Org. Jedin. Org. Unit	HEA	U. Prof. Dr. Prof. Prof. Hoc
No. i faqes Strj. stranica No. pages	- 05 -	Data/ Datum: Date:
PRISHTINË / A		NO. 2

Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
 NDËRMJET
 MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME
 DHE
 MINISTRISË SË EKONOMISË DHE AMBIENTIT

Dhjetor 2020, Prishtinë

Duke u bazuar në nenin 10 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr.7 dt. 01 Mars, 2019), nenin 8 paragrafi 1.4. të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 2 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ligjin Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.1/20 dt. 19 Mars 2020 dhe Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR.07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 (Gazeta Zyrtare, Nr. 2/2020/dt. 07 Gusht 2020, si dhe nenin 38 paragrafin 5 të Rregullores (QRK) Nr. 22/2020 për Ri integrimin e Personave të Riatdhesuar,

1. **Ministria e Punëve të Brendshme** e përfaqësuar nga Ministri i Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejme MPB) dhe

2. **Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit** e përfaqësuar nga Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit (në tekstin e mëtejme MEA), lidhin

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje bashkëpunimi është transferimi i Buxhetit nga MPB në MEA për zbatimin e *“Skemës së akomodimit me qira për personat e riatdhesuar”* si masë e përkrahjes emergjente të personave të riatdhesuar si dhe përcaktimi i obligimeve të ndërsjella institucionale.

Neni 2 Obligimet e palëve

1. Obligimet e MPB-së:

1.1. MPB transferon në MEA buxhetin në vlerë prej 200,000.00 € (dyqind mijë euro e zero-zero cent) për zbatimin e skemës së akomodimit me qira për personat e riatdhesuar, sipas Vendimeve të Komunave relevante dhe Komisionit të Ankesave.

1.2. Buxheti sipas pikës 1.1. të kësaj marrëveshje do të transferohet nga kategoria “Mallra e Shërbime” nga kodi i organizatës: “214-Ministria e Punëve të Brendshme”, me kod të programit “20900 Ri integrimi i Personave të riatdhesuar” në kodin e organizatës “213 -Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit” me kod të programit “50400 Departamenti i Planifikimit Hapësinor,

Ndërtimit dhe Banimit". Kjo lëvizje/transfer i buxhetit është paraqitur edhe me projekt ligjin mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.

1.3. MPB/Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (tani e tutje "DRPR") i përcjell MEA/Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit (tani e tutje DPHNB) Vendimet dhe informatat e nevojshme për zbatimin e kësaj marrëveshje.

2. Obligimet e MEA-së:

2.1. Planifikimi i buxhetit për zbatimin e skemës së qirasë për personat e riatdhesuar për vitet në vijim do të bëhet nga MEA, në kuadër të Buxhetit vjetor të MEA-së.

2.2. Financimi i "*Skemës së akomodimit me qira për personat e riatdhesuar*" sigurohet nga MEA/DPHNB, sipas Vendimeve të Komisioneve Komunale për Riintegrim (KKR) dhe/ose Vendimeve të Komisionit të Ankesave (KA), në harmoni me Rregulloren (QRK) për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.

2.3. MEA buxhetin e transferuar nga MPB, sipas pikës 1.1, do të shpenzon vetëm për qëllimin e dedikuar në këtë marrëveshje bashkëpunimi.

2.4. MEA/DPHNB do të raportojë për ecurinë dhe zbatimin e marrëveshjes ashtu siç parashihet në Nenin 3 të kësaj marrëveshje.

Neni 3

Komunikimi, mbikëqyrja dhe raportimi

1. MPB dhe MEA do të emërojnë nga një zyrtar, i cili do të jetë pikë kontakti për palën tjetër.
2. Përfaqësues të MPB-së dhe MEA-së do të realizojnë takime të rregullta tre mujore ku do të diskutohet progresi dhe mbarëvajtja e zbatimit të kësaj Marrëveshje. Në rast nevojë mund të realizohen edhe takime *ad-hoc* me iniciativën e secilës palë të marrëveshjes.
4. MEA njofton MPB/DRPR përmes raporteve të rregullta mujore për realizimin e obligimeve që dalin nga kjo marrëveshje duke përfshirë edhe shpenzimet buxhetore, dhe ndihmën e ofruar për secilin rast veç e veç. Në rast nevojë, sipas kërkesës së MPB/DRPR-së, MEA ofron edhe raporte të veçanta që ndërlidhen me banimin me qira të personave të riatdhesuar.
5. MEA/DPHNB njofton MPB/DRPR-në për njetet e planifikuara buxhetore për skemën e akomodimit me qira të personave të riatdhesuar në çdo fillim të vitit të ri fiskal.
6. Zbatimi i kësaj Marrëveshje do të mbikëqyret nga MPB/DRPR, sipas mandatit të përcaktuar me Rregulloren (QRK) për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar.

Neni 4

Mbrojtja e të dhënave personale

Informatat e pranuar gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje të bashkëpunimit do të trajtohen me konfidencialitet dhe në harmoni të plotë me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 5 **Ndryshimet, Plotësimet dhe Shfuqizimi**

1. Secila palë mund të propozoj plotësimin dhe ndryshimin e kësaj Marrëveshje.
2. Çdo plotësim dhe ndryshim i kësaj marrëveshje do të bëhet me shkrim dhe me pëlqimin paraprak të të dyja palëve nënshkruese të marrëveshjes.
3. Kjo marrëveshje mund të shkëputet nga secila palë, me njoftim me shkrim, ndërsa marrëveshja vazhdon të zbatohet deri në fund të atij viti fiskal.

Neni 6 **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

1. Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet që në mënyrë miqësore t'i zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet eventuale që dalin nga kjo marrëveshje.
2. Nëse përpjekjet për zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjeve nuk kanë sukses, kontesti do të drejtohet Gjykatës kompetente, në bazë të ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 7 **Numri i kopjeve**

Marrëveshja e bashkëpunimit është nënshkruar në katër kopje, nga dy për secilën palë nënshkruese.

Neni 8 **Hyrja në fuqi**

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo Marrëveshje bashkëpunimi të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Palët nënshkruese:

Prishtinë, me datë 28 / 12 / 2020

Agim Veliu
Ministër i MPP

